

## Akt Themelimi i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “Parknexa” Sh.p.k.

Në Tiranë, sot më datë 04.07.2024, me cilësinë e ortakut themelues, z. Aleksandër Prenga, i datëlindjes 21.06.1992, identifikuar me letërnjoftim me nr.personal J20621091V, madhor me zotësi juridike për të vepruar, me vullnet të lirë, të plotë e të sinqertë, mbështetur në:

Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në Ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” të ndryshuar me ligjin 129/2014, në ligjin 9723 datë 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit” I ndryshuar, kam vendosur krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të Kufizuar me emërtimin “Parknexa” Shpk (më poshtë quajtur “shoqëria”)

### Kreu I

Krijimi, personaliteti juridik, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

#### Neni 1:

Krijimi, personaliteti juridik

Shoqëria “Parknexa” Shpk është person juridik i së drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur “shoqëria”)

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara në ligj.

Shoqëria “Parknexa” Shpk, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga “ortakët” të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën pashlyer të kontributeve të nënshkuara. Kontributi I ortakëve përben kapitalin e regjistruar të shoqërisë.


Ortakët gëzojnë kuotën e tyre në shoqëri, në përpjesëtim më kontributin që kanë dhënë në kapital.

#### Neni 2:

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Shërbime nëpërmjet platformave digjitale, komunikim dhe menaxhim digjital, fushata promovionale, etj.
- Ndërtim i programeve kompjuterike (software development), arkitekturë dhe mirmbajtje e rrjeteve kompjuterike, ndërtim faqesh interneti, ofrimin e shërbimeve së këshillimit në



fushën e elektronikës dhe programimit, ofrimin e shërbimeve të internetit dhe cdo lloj aktiviteti mbështes për teknologjine e informacionit.

Të gjitha aktivitetet e lartpërmendura mund të zhvillohen si ne tregun tregtar kombëtar dhe ne atë nderkombëtar.

Shoqëria do te kryejë të gjitha aktivitetet e mesiperme, si dhe cdo aktivitet tjetër që nuk është i ndaluar nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.

### **Neni 3**

#### **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë data e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për një periudhë të pacaktuar.

### **Neni 4**

#### **Selia**

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Sali Butka, Pallati Nord, Shkalla 2, Apartamenti 12, Tiranë, Shqiperi. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e tij, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

### **Kreu II**

#### **Kapitali**

### **Neni 5**


#### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000.00 Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

Themelues Aleksandër Prenga Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100,000.00 lekë që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

### **Neni 6**

#### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**



Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund ta detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

## **Neni 7**

### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## **KREU III**

### **Organet Vendimmarrëse Dhe Drejtuese**

## **Neni 8**

### **Organi Vendimmarrës**

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;



- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin dhe shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pikë;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i Ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 9**

##### **Administrimi**

Administrator i shoqërisë është znj. Rejda Vojka, e datëlindjes 02.05.1992, identifikuar me letërnjoftim me nr.personal J25502062M.

Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

Administrator i shoqërisë mund të emërohet edhe një person I tretë jashtë ortakërisë.

#### **Neni 10**

##### **Kompetencat e Administratorit**

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqëson shoqërine tregtare;



- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë; c) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, si parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raporton përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- f) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori është i detyruar të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktiviteti i shoqërisë nuk i mbulon detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## Neni 11

### Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

I. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në termsi, duke i kushtuar vemendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së

shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

c) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyre solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen Ortakëve kontributet;

b) u paguan Ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

c) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **Kreu IV**

##### **Viti financiar-ekspertët**

#### **Neni 12**

##### **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i



parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

### **Neni 13**

#### **Bilanci i shoqërisë dhe dividendët**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakëve miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakëve vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

### **Neni 14**

#### **Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me statutin e shoqërisë dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në statutin e shoqërisë, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

### **Neni 15**

#### **Dispozita Përfundimtare**


Ky Akt Themelimi i Shoqërisë "Parknexa" Shpk u redaktua nga unë, ortaku themelues i shoqërisë në 3 ekzemplare me vlera të njëjta juridike në gjuhën shqipe me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike

#### **ORTAKU THEMELUES**

#### **I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR**

**"Parknexa" Shpk**

**Aleksandër Prenga**

  
(i nënshkrim)